|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | [illegible] |
| 3 | 19.12.2013 | 28,000.00 | All | AL | [illegible] Murati [illegible] |

*Nga verifikime të mëtejshme lidhur me aktivitetet tregtare, rezulton qe shtetasi [illegible] ka të regjistruar:*

*- Subjektin "Ryfed" shpk, me NIPT J81901002V.*
*- Subjektin "Coma Mining Albanien" shpk, me NIPT L12102001O në të cilin zotëron [illegible] të kuotave. Ortakë të tjerë të kësaj shoqërie janë shtetasit kosovar Remzi Shala, i cili zotëron [illegible] të kuotave dhe shtetasi Asllan Halili që zotëron me 5 %.*

***Meleqe Murati***

*Nga të dhënat nga Ak-Invest, shtetësja Meleqe Murati rezulton të jetë përfituesja e një transferte nga Italia me vlerë ~1 000 euro. Konkretisht, tabela si vijon:*

| Nr. | Data | Valuta | Shuma | Derguesi | Shteti Dërgues | Marrësi | Shteti Marrës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 12.08.2013 | Eur | 999.99 | Suzana Lala | IT | Meleqe Murati | AL |

***Ervis Murati***
*Nga të dhënat nga Ak-Invest, shtetasi Ervis Murati rezulton të jetë përfitues e një trasnferte nga Italia me vlerë vlerë ~1 000 euro. Konkretisht, tabela si vijon:*

| Nr. | Data | Valuta | Shuma | Derguesi | Shteti Dërgues | Marrësi | Shteti Marrës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 02.04.2012 | Eur | 999 | Besnik Shehu | IT | Ervis Murati | AL |

*Një shtetas me gjeneralitetet Ervis Murati rezulton të jetë dërgues i 17 transfertave me vlerë ~ 1 800 euro për periudhën 2012-2016. Tabela, si vijon :*

| Nr. | Data | Valuta | Shuma | Derguesi | Shteti Dërgues | Marrësi | Shteti Marrës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 24.09.2012 | Eur | 100 | Ervis Murati | IT | Dhurata Bifsha | AL |
| 2 | 05.08.2015 | Eur | 100 | Ervis Murati | FR | Indrit Murati | AL |
| 3 | 13.08.2015 | Eur | 135.57 | Ervis Murati | GB | Bujar Murati | AL |
| 4 | 20.08.2015 | Eur | 200 | Ervis Murati | IT | Eljon Hakballa | AL |
| 5 | 01.09.2015 | Eur | 100 | Ervis Murati | IT | Nadire Murati | AL |
| 6 | 05.10.2015 | Eur | 99.99 | Ervis Murati | FR | Indrit Murati | AL |
| 7 | 05.10.2015 | Eur | 100 | Ervis Murati | FR | Indrit Murati | AL |
| 8 | 26.11.2015 | All | 14,930.22 | Ervis Murati | GB | Stilana Peshku | AL |
| 9 | 15.02.2016 | All | 15,497.29 | Ervis Murati | GB | Stilana Peshku | AL |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *10* | *24.02.2016* | *Eur* | *117.39* | *Ervis Murati* | *GB* | *Leo Ademi* | *AL* |
| *11* | *14.03.2016* | *All* | *17,246.45* | *Ervis Murati* | *GB* | *Hekri Zeka* | *AL* |
| *12* | *15.03.2016* | *Eur* | *50* | *Ervis Murati* | *IT* | *Bashkim Greca* | *AL* |
| *13* | *17.03.2016* | *All* | *16290.88* | *Ervis Murati* | *GB* | *Bujar Murati* | *AL* |
| *14* | *31.03.2016* | *All* | *4,273.2* | *Ervis Murati* | *GB* | *Shahe Shahini* | *AL* |
| *15* | *12.04.2016* | *All* | *33,550.71* | *Ervis Murati* | *GB* | *Mihane Daci* | *AL* |
| *16* | *15.04.2016* | *Eur* | *100* | *Ervis Murati* | *IT* | *Nadire Murati* | *AL* |
| *17* | *25.05.2016* | *All* | *6893.99* | *Ervis Murati* | *GB* | *Stilana Peshku* | *AL* |

*Nga të dhënat Ëestern Union, shtetasi Ervis Murati rezulton të ketë përfituar vlerën ~ 4 300 euro, nëpërmjet 15 transfertave nga Italia dhe Hungaria. Për më shumë hollësi, tabela si vijon:*

| ***Nr.*** | ***Data*** | ***Shuma*** | ***Monedha*** | ***Shteti*** | ***Derguesi*** | ***Marrës*** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *19.02.2013* | *100.00* | *Eur* | *IT* | *Fatjon Murati* | *Ervis Murati* |
| *2* | *25.02.2013* | *474.00* | *Eur* | *IT* | *Fatjon Murati* | *Ervis Murati* |
| *3* | *01.08.2013* | *100.01* | *Eur* | *HU* | *Zsuzsanna Vajda* | *Ervis Murati* |
| *4* | *12.08.2013* | *995.00* | *Eur* | *IT* | *Biagio Clemente* | *Ervis Murati* |
| *5* | *23.12.2013* | *200.00* | *Eur* | *HU* | *Zsuzsanna Vajda* | *Ervis Murati* |
| *6* | *28.12.2013* | *200.00* | *Eur* | *IT* | *Suzana Lala* | *Ervis Murati* |
| *7* | *31.12.2013* | *500.00* | *Eur* | *IT* | *Naim Lusha* | *Ervis Murati* |
| *8* | *03.01.2014* | *500.00* | *Eur* | *IT* | *Suzana Lala* | *Ervis Murati* |
| *9* | *07.01.2014* | *499.00* | *Eur* | *IT* | *Suzana Lala* | *Ervis Murati* |
| *10* | *15.03.2015* | *50.00* | *Eur* | *IT* | *Suzana Lala* | *Ervis Murati* |
| *11* | *16.03.2015* | *150.00* | *Eur* | *IT* | *Naim Lusha* | *Ervis Murati* |
| *12* | *25.03.2015* | *140.00* | *Eur* | *IT* | *Ion Negoi* | *Ervis Murati* |
| *13* | *26.05.2015* | *50.00* | *Eur* | *IT* | *Suzana Lala* | *Ervis Murati* |
| *14* | *23.06.2015* | *250.00* | *Eur* | *IT* | *Artan Seferi* | *Ervis Murati* |
| *15* | *01.10.2015* | *100.00* | *Eur* | *SE* | *Klejdi Hoxha* | *Ervis Murati* |

*Një shtetas me gjeneralitetet Ervis Murati rezulton të jetë dërgues i 5 transfertave me vlerë ~2 000 euro për periudhën 2012-2016. Tabela si vijon:*

| ***Nr.*** | ***Data*** | ***Shuma*** | ***Monedha*** | ***Shteti*** | ***Derguesi*** | ***Marrës*** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *25.08.2012* | *300.00* | *Eur* | *IT* | *Ervis Murati* | *Ramazan Murati* |
| *2* | *30.08.2013* | *500.00* | *Eur* | *HU* | *Ervis Murati* | *Ramazan Murati* |
| *3* | *31.12.2013* | *150.00* | *Eur* | *HU* | *Ervis Murati* | *Zsuzsanna Vajda* |
| *4* | *31.07.2015* | *953.00* | *Eur* | *IT* | *Ervis Murati* | *Liliana Cursaru* |
| *5* | *04.01.2016* | *100.00* | *Eur* | *HR* | *Ervis Murati* | *Qerim Lumi* |

***Fran Vokrri***

*Nga të dhëna nga Ak- Invest, shtetasi Fran Vokrri rezulton të jetë përfitues i një trasnferte nga Italia me vlerë ~1 000 euro. Konkretisht, tabela si vijon:*

| *Nr.* | *Data* | *Valuta* | *Shuma* | *Derguesi* | *Shteti Dërgues* | *Marrësi* | *Shteti Marrës* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *13.01.2012* | *Eur* | *965.00* | *Alessandro Turazzi* | *IT* | *Fran Vokrri* | *AL* |

*Një shtetas me gjeneralitetet Fran Vokrri rezulton të jetë i 3 transfertave nga Greqia me vlerë ~ 900 euro. Tabela si vijon:*

| ***Nr.*** | ***Data*** | ***Valuta*** | ***Shuma*** | ***Derguesi*** | ***Shteti Dërgues*** | ***Marrësi*** | ***Shteti Marrës*** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *05.09.2011* | *Eur* | *182.00* | *Fran Vokrri* | *GR* | *Lek Vokrri* | *AL* |
| *2* | *19.10.2011* | *Eur* | *228.00* | *Fran Vokrri* | *GR* | *Markeljan Brunga* | *AL* |
| *3* | *13.07.2013* | *Eur* | *500.00* | *Fran Vokrri* | *GR* | *Zef Vokrri* | *AL* |

*Nga të dhënat Ëestern Union, shtetasi Fran Vokrri rezulton të jetë përfitues i 5 transfertave nga Italia dhe Greqia me vlerë ~3 000 euro. Për më shumë hollësi, tabela si vijon:*

| ***Nr.*** | ***Data*** | ***Shuma*** | ***Monedha*** | ***Shteti*** | ***Derguesi*** | ***Marrës*** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *14.06.2011* | *600.00* | *Eur* | *GR* | *Altin Palokaj* | *Fran Vokrri* |
| *2* | *15.06.2011* | *400.00* | *Eur* | *GR* | *Kastriot Cara* | *Fran Vokrri* |
| *3* | *31.07.2013* | *474.00* | *Eur* | *IT* | *Mauro Picelli* | *Fran Vokrri* |
| *4* | *29.08.2013* | *900.00* | *Eur* | *IT* | *Mauro Picelli* | *Fran Vokrri* |
| *5* | *30.08.2013* | *628.00* | *Eur* | *IT* | *Fatmir Celoaliaj* | *Fran Vokrri* |

***Xhuljeta Vokrri,***

*Nga të dhënat Ëestern Union, shtetase Xhuljeta Vokrri rezulton të jetë përfituese e një transferte nga Italia me vlerë 150 euro. Konkretisht, tabela si vijon:*

| ***Nr.*** | ***Data*** | ***Shuma*** | ***Monedha*** | ***Shteti*** | ***Derguesi*** | ***Marrës*** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *02.12.2015* | *150.00* | *Eur* | *IT* | *Arben Vokrri* | *Xhuljeta Vokrri* |

***Xhevit Azuni***

*Nga të dhënat Ëestern Union, shtetasi rezulton të jetë përfitues i një transferte nga Italia me vlerë ~1 000 euro. Konkretisht, tabela si vijon:*

| ***Nr.*** | ***Data*** | ***Shuma*** | ***Monedha*** | ***Shteti*** | ***Derguesi*** | ***Marrës*** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *18.06.2014* | *990.00* | *Eur* | *IT* | *Qerim Azuni* | *Xhevit Azuni* |

*Një shtetas me gjeneralitetet Xhevit Azuni rezulton të jetë dërgues i një trasferte nga Greqia me vlerë 500 euro. Tabela, si vijon:*

| ***Nr.*** | ***Data*** | ***Shuma*** | ***Monedha*** | ***Shteti*** | ***Derguesi*** | ***Marrës*** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *19.12.2013* | *500.00* | *Eur* | *GR* | *Xhevit Azuni* | *Avdulla Azuni* |

*Kemi kryer verifikimet edhe për familjarë të tjerë të shtetasit Fatjon Murati, konkretisht për shtetasin Ylli Ramazan Murati, i datëlindjes 20.05.1985 dhe shtetases Tefta Ramazan Alhysa (Murati) e datelindjes 19.02.1972, nga ku rezulton sa vijon:*

***Ylli Ramazan Murati***

*Më datë 01.12.2007 ka porositur apartament + dyqan, me vlerë 175 000 euro.*
*Më datë 06.08.2010 ka shitur apartament me vlerë 55 000 euro, shtetasit Zenulla Hasan Mata.*
*Më datë 17.04.2013 ka porositur apartamnet banimi me vlerë 12 370 000 lekë, tek shoqëria "Aleksandros" shpk (NIPT K59418207T)*
*Më datë 01.07.2013 ka porositur dyqan me vlerë 12 370 000 lekë, tek shoqëria :Aster" shpk (NIPT K88820201T).*
*Më datë 03.07.2014 ka blerë apartament me vlerë 80 000 euro, tek shoqëria "Albabras" shpk (NIPT K91403011R) me datë 22.09.2015 i ka dhënë hua me vlerë 17 000 euro shtetasit Astrit Bajram Haka.*
*Me datë 04.01.2012 është kredituar llogaria në Bankën "Intesa San Paolo", në emër të Ylli Ramazan Murati me vlerën 15 315 euro me përshkrimin: "Ramazan Murati derdhje për likujdim kredie".*

*Nga verifikimet ne **QKB** rezulton se shtetasi Ylli Ramazan Murati ka dy biznese të regjistruar:*

*Ma datë 02.05.2008 është regjistruar aktiviteti (lavazh makina- rruga "Don Bosko", pranë parkut të autobuzave, Tiranë) me NIPT K81702028O.*
*Më datë 06.05.2010 është regjistruar aktiviteti (bar- kafe- Unaza e Re, pranë Astir Tiranë me NIPT L01706005M.*

*Duke u nisur nga transaksionet në vlera të konisderueshme, shpesh herë nga shtetas me të cilët nuk mund të identifikohet lidhja, blerja e pasurive të paluajtshme dhe në shumicën e rasteve mungesa e një biznesi, që mund të gjenerojë të ardhura te ligjshme, dyshojmë se shumat e mësipërme rrjedhin nga veprimtaria e kundraligjshme e shtetasve të lartpërmendur.*

*Me qellim dokumentimin e aktivitetit kriminal te shtetasve nen hetim si dhe pasurive qe mund te jene si prejardhje e veprimtarise kriminale jane kryer edhe nje sere veprimesh te tjera hetimore nga ku ka rezultuar se:*

Me ane te shkreses nr.17234Prot/E.B, date 22.11.2019 I eshte kerkuar informacion **INTERPOL Tirana,** e cila me ane te shkreses nr.14249KL/6Prot date 30.12.2019 ka kthyer pergjije, nga ku ka rezultuar se: Shtetasi **Fatjon Ramazan Murataj** i datelindjes 14.01.1990, lindur ne Kukes eshte hetuar nga autoritetet policore te Venecias ne lidhje me nje ceshtje te trafikimit te narkotikeve, ku eshte sekuestruar nje sasi prej 5 kilograme kokaine. Ne kete ngjarje jane arrestuar tre shtetas ku njeri prej tyre eshte shtetasi Fatjon Murataj.

Po keshtu nga INTERFORCE Itali me ane te shkreses N/Rif.UCI/ALB/RF331-6/FR date 10 Shkurt 2020 na eshte kthyer pergjigje se: "Shtetasi Fatjon Murati I dtl.14.01.1990 lindur ne Kukes, ne ngarkim ndaluar nga policia me daten 28.02.2015 per vepren penale te blerjes se mallrave te vjedhur, posedim illegal te armeve dhe narkotikeve dhe si vijim me daten 12.03.2015 u vendos ne burgun e Venecias. Me daten 04.08.2015 u vendos ne masen e arrestit shtepiak. Ne ngarkim masa e arrestit ne burg eshte dhene me daten 05.11.2015 nga GIP I Gjykates se Trevizos per shkelje te ligjit mbi posedimin e armeve, narkotikeve dhe blerje mallrash te vjedhur. Me date 08.08.2019 Prokuroria e Republikes prane Gjykates se Venecias dha ne daten 08.08.2019 masen e ekzekutimit te denimeve konkuruese me urdherin per burgim nr.344/2019 duke qene i denuar me 5 vjet e 7 muaj e 5 dite burgim".

Me ane te shkreses nr.17234Prot E,B date 22.11.2019 derguar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane I eshte kerkuar informacion per shtetasit objekt hetimi, e cila me ane te shkreses nr.4222/1Prot date 18.12.2019 na ka informuar se shtetasi Fatjon Murati me vendimin nr.3090 date 12.10.2016 eshte denuar per vepren penale te ndertimit te paligjshem.

Gjithashtu me date 08.10.2022 eshte bere ndalimi i ketij shtetasi pasi eshte i dyshuar per kryerjen e vepres penale te "Mbajtjes pa leje te armeve dhe municionit luftarak shperthyese dhe municionit", te kryer ne bashkepunim, parashikuar nga neni 278/5 dhe 25 i K.Penal.Arrestimi i ketij shtetasi u be pasi nga hetimet e zhvilluara ne funksion te procedimit penal nr.5257 te vitit 2022 jane siguruar fakte dhe prova se shtetasi Fatjon Ramazan Murrati ne bashkepunim me shtetasin Kristjan Arben Gjini jane poseduesit zoteruesit e disa armeve zjarri te llojeve dhe kalibrave te ndryshem si fisheke silenciatore qe jane gjetur dhe sekuestruar ne cilesine e proves materiale gjate kontrollit te ushtruar me date 12.07.2022 ne ambientet e marra me qera nga shtetasi Arben Gjini ne kompleksin rezidencial FUSHA (Sofia) afer qendres TregetareTEG.

**Shtetasi Qerim Azuni** I datelindjes 10.01.1990 ne Tirane, me shume precedent penal, disa here arrestuar ne Itali, se fundmi sinjalizohet. Ne ngarkim masa e bashkimit te denimeve SIEP nr.613/2018 dhe njekohesisht per burgim dhene me 13.12.2018 nga Prokuroria e Republikes prane Gjykates se Verones sepse duhet te shlyeje denimin me 4 vjet e 6 muaj dhe 18 dite burgim dhe gjoben 13.400 Euro. Kjo mase kerkimi rezulton te jete ne nivel kombetar.
**Shtetasi Nik Vokrri** lindur me 08.11.1975 ne Mirdite per procedimin penal nr.9471/2014 RGN-8407/20415 RGGIP dhene nga autoriteti Gjyqesot I Venecias denuar me 3 muaj burgim per shkelje te normative per narkotiket.

INTERPOL
nga ku
...kes

***Shtetasi Klaudio Paluka*** *I datelindjes 14.08.1981, lindur e banues ne Mirdite arrestuar disa here ne Itali. Denuar nga Prokuroria e Repiblikes se Venecias me 2 vjet e 11 muaj e 2 dite burgim.*

***Shtetasi Armando Zajsi*** *I datelindjes 13.05.1989 I arrestuar me daten 26.04.2016 per vepren penale te vjedhjes se banesss dhe grup criminal ne egzekutim te mases se arrestit ne burg dhene nga autoriteti Gjyqesor I Venecias ne lidhje me procedimin penal 3471/2016 per veprat penale kunder pasurise dhe shkeljes te normative per narkotiket. Me date 24.06.2019 me urdher te magjistratit te Mbikqyrjes perfitoi masen alternative te sherbimit te proves.*

*Me shkresen nr.17234Prot E.B date 22.11.2019 I edhte kerkuar informacion* ***Qendres Kombetare te Biznesit*** *e cila me ane te shreses nr.14798/1Prot date 16.12.2019 ka derguar informacion nga ku rezulton se:*

*Shtetasi* ***Fatjon Muratii*** *datelindjes 14.01.1990 figuron:*

- *I rregjistruar si person fizik me NIPT L71814001H. Hapur me date 14.06.2017 me fushe veprimtarie Tregeti me pakice te artikujve te imet ushqimor.*
- *person fizik me NIPT L81619013E Bar Kafe. Shtetasi Ylli Murati me NIPT K81702028O person fizik Lavazh Makinash.*

*Shtetasi* ***Qerim Azuni*** *me NIPT L71327019N hapur me date 27.10.2017 Bar Kafe, me NIPT L81711018H hapur me date 11.05.2018 Bar Kafe.*

*Nga Drejtoria e Pergjitheshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor me ane te shkreses nr.25271Prot date 04.12.2019 ka rezultuar se shtetasi Qerim Azuni ka ne pronesi automjetin me targa AA 257 IZ.*

*Po keshtu dhe nga pergjigjet e bankave te nivelit te dyte ka rezultuar se asnje nga personat nuk kane gjendje ne llogarite e ketyre bankave.*

*Nga verifikimet e bera nga ana jone online ne sistemin e ASHK rezulton se;*

*Shtetasi Fatjon Murati ka aktualisht ne pronesi;*

- *nje siperfaqe ndertimi 120 m2 ne zonen kadastrale 8330 me nr,pasurie 4/40/ND+1-2 te cilen e ka perfituar me leje legalizimi me date 30.04.2020.*

*Shtetasi Ylli Murati ka ne pronesi:*

- *nje dyqan me siperfaqe 40.m2 ne rrugen Lord Bajron zona kadastrale 8310 numer pasurie 9/73-N7,*
- *nje apartament me siperfaqe 90.30.m2 ne rrugen Shaban Matraku zona kadastrale 3866 numer pasurie 215/189+3-N14.*

*Shtetasja Meqele Zenun Murati (nena e shtetasve Fatjon Murati) ka ne pronesi;*

- *nje ndertese 7+1-kateshe me siperfaqe ndertimi 317m2 ne zonen kadastrale 8330 me nr,pasurie 4/40/ND+1-1 te cilen e ka perfituar me leje legalizimi me date 30.04.2020. Pasuria Ndersa personat e tjere obiekt hetimi nuk figurojne te kene pasuri".*

10. Sa më sipër, organi i akuzës ka argumentuar se: *"Nga analiza në tërësi e provave dhe akteve të administruara nga hetimi paraprak i ketij procedimi penal, si dhe cmuarjes se tyre me objektivitet, arrij ne konkluzionin se pasuritë e paluajtshme te shtetasit Fatjon Murati dhe familjareve te tij dyshohet, pertej cdo dyshimi te arsyeshem te bazuar ne prova, se janë produkte te veprave penale ose i veprimtarisë kriminale, ne te cilat ka qene i pershire, si dhe ka rrezik qe disponimi i lire i tyre mund te rendojë pasojat e vepres penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal, duke u tjetërsuar ose transferuar tek te tretet".*

## II. Vlerësimi i Gjykatës.

11. Si shqyrtoi përmbajtjen e kërkesës dhe aktet shkresore bashkëlidhur saj Gjykata konkludoi se ajo është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet sipas objektit të saj.

12. Në këtë konkluzion Gjykata arriti duke mbajtur në konsideratë faktin se, sekuestroja preventive, në bazë të neneve 274-276 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet në rastin kur ekziston rreziku që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal (qëndrim ky i mbajtur edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë nr.201, datë 09.12.2015).

13. Më konkretisht në nenin 274 të K.Pr.Penale përcaktohet se: *"1.Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal".*

14. Nga interpretimi i dispozës së sipërcituar rezulton se sekuestroja preventive mund të urdhërohet për "qëllime të parandalimit" të pasojave apo veprimeve të paligjshme kriminale, në rastet e parashikuara prej pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa në rastet e parashikuara prej pikës "2", të po këtij neni, sekuestroja preventive mund të urdhërohet për "qëllime të sekuestrimit", sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 36 i Kodit Penal. Në rastin e dytë, kemi të bëjmë me një "goditje" më efikase të avantazheve ekomomike që vijnë si rezultat i veprimtarive kriminale, dhe masa në fakt, merr trajtën e një sanksioni penal. Kushtet e nevojshme ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive njëkohësisht janë: prania e dyshimit të arsyeshëm të mbështetur në

8330 me
.2020.

prova, d.m.th prania e elementit të ashtuquajtur *fumus boni iuris*, si dhe prania e elementit të ashtuquajtur *periculum in mora* [rreziku i vonesës] deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar.

15. Objekti i sekuestros preventive përcaktohet shprehimisht në sendet që lidhen me veprën penale të supozuar se është kryer, prandaj nuk duhet lejuar caktimi i masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, përpara se të jetë kryer vepra penale, apo thjesht mbi bazën një shpjegimi të normës penale abstrakte. Për këtë arsye, është e nevojshme prania e fakteve provuese që lidhin sendin apo pasurinë me natyrën dhe llojin e veprës penale të supozuar nga ana e organit të akuzës, në raport edhe me faktet e parashtruara apo të grumbulluara mbi çështjen konkrete. Këto fakte nuk duhet të vlerësohen në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por mbi baza aktuale dhe konkrete, mbështetur në të dhëna objektive që hedhin dritë mbi rëndimin, zgjatjen, apo kryerjen e të tjerave veprime kriminale, në raport me cenimin që mendohet se i bëhet marrëdhënies juridike të mbrojtur nga norma penale.

16. Objekti i sekuestros preventive, sipas pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, përbëhet nga "*sendet që lidhen me veprën penale*", domethënë nga marrëdhënia e krijuar midis sendit dhe veprës penale të kryer, apo me të ardhurat që vijnë si rezultat i kryerjes së veprës penale, po të vazhdojë mbajtja e mëtejshme e sendit. Gjykata çmon se është e kuptueshme që kemi të bëjmë me një raport midis sendit dhe veprës penale, i cili nuk është i rastësishëm, por i konceptuar dhe vënë në funksion të natyrës së veprës penale.

17. Në rastin e pikës "2" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, objekti i sekuestros përbëhet nga sendet e sekuestrueshme, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal, por të qenit i sekuestrueshëm i sendit, nuk është kusht i vetëm për përligjjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, pasi edhe në këtë rast, janë të nevojshme prania e dy elementëve. *Së pari*: prania e elementit të *fumus commissis delicti*, domethënë që sendi duhet të ketë qenë ai që ka shërbyer apo ai i destinuar për kryerjen e veprës penale, apo se është pikërisht ai që përbën produktin e veprës penale, shpërblimeve, të dhëna, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i së cilit, përbën veprën penale. *Së dyti*, është e nevojshme vërtetimi i një lidhjeje të posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme (domethënë të qëndrueshme) midis sendit dhe veprimit penal të kundërligjshëm.

18. Në çdo rast, në mënyrë që gjykata të procedojë me marrjen e një vendimi për vendosjen e sekuestros preventive për efekt të një procedimi të caktuar është e nevojshme të përcaktohet lidhja organike ndërmjet pasurisë që kërkohet të sekuestrohet dhe veprës penale për të cilën është dënuar personi, me qëllim për t'i mundësuar gjykatës një vlerësim objektiv që kjo pasuri është krijuar nga veprimtaria kriminale.

19. Në rastin konkret, rezulton e provuar se më datë 07.02.2018 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit të referuar nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr.2600 për veprën penale *"Pastrimi i produkteve të veprës*

*penale ose i veprimtarisë kriminale",* parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Ndërsa më 10.10.2022 Prokuroria ka regjistruar nw regjistrin e veprave penale emrin e personit nën hetim Fatjon Murati për veprën penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale",* parashikuar nga neni 287 i K.Penal në kuadër të procedimit penal të sipërcituar 2600/2018.

20. Gjykata vlerëson të theksoi se, që të lind përgjegjësia penale sipas kësaj dispozite, duhet të vërtetohet ekzistenca e dyshimit të një veprimtarie kriminale që ka gjeneruar të ardhura. Vënia në qarkullim me qëllim mbulimi të origjinës së tyre të kundërligjshme e shumave të parave dhe aseteve të tjera të kundërligjshme të përfituara nga vepra penale, zakonisht bëhet nëpërmjet investimit në biznese, rikapitalizimi të tyre në ekonomi, përdorimit të transfertave të shpeshta bankare duke u përzier me burime të ligjshme të ardhurash apo duke i paraqitur në tërësi këto të ardhura si të ligjshme. Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë si subjekti që ka kryer veprën penale bazë, pra ai që ka kryer veprën penale nga e cila janë gjeneruar të ardhurat, ashtu edhe çdo subjekt, person i tretë që nuk ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale bazë, por që ka dijeni për burimin e kundërligjshëm të të ardhurave.

21. Më konkretisht që të ekzistoj vepra penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale",* parashikuar nga neni 287 i K.Penal duhet të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: **Së pari**, personi duhet të jetë i dënuar apo ndaj tij të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova se është i përfshirë në veprimtari kriminale, prej tw cilave kanë gjeneruar tw ardhura tw paligjshme. **Së dyti**, si rrjedhojë e përfshirjes në këtë veprimtari kriminale, personi të ketë krijuar pasuri në nivel dukshëm të pajustifikuar ekonomik, pra burimi i krijimit të saj të jetë i paligjshëm, i padeklaruar ligjërisht në organet kompetente shtetërore. **Së treti,** pasuria e vënë, si rezultat i përfshirjes në veprimtari kriminale të zotërohet plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë prej tij, apo nga persona fizike/juridik, për të cilat ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë apo veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht/plotësisht ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një forme të caktuar sipas rasteve të parashikuara në gërmat nga a-dh të nenit 287 të K.Penal (këmbim/transferim/fshehjes/mënyres së fitimit të pronësisë/përdorimit/posedimit të pasurisë/transaksione financiare të copëzuara/investimit). **Së katërti,** koha e krijimit të pasurisë, pasuria e vënë duhet të jetë krijuar pas përfshirjes së subjektit në veprimtarinë kriminale. Nga aktet e hetimeve paraprake rezulton e provuar se shtetasi Fatjon Murati ka qenë i dënuar apo i përfshirë në veprimtari kriminale, për vepra penale të cilat gjenerojnë të ardhura të paligjshme (lëndë narkotike).

22. Në rastin konkret nga shkresa me nr.14249KL/6Prot date 30.12.2019 e INTERPOL Tirana, me lëndë *"Kthim përgjigje",* rezulton e provuar se shtetasi Fatjon Ramazan Murataj i datëlindjes 14.01.1990, është hetuar nga autoritetet policore të Venecias në lidhje me një çështje të trafikimit të narkotikëve, ku është sekuestruar një sasi prej 5 kilogram kokainë. Në këtë ngjarje janë arrestuar tre shtetas ku njeri prej tyre është shtetasi Fatjon Murataj.

23. Gjithashtu, nga shkresa N/Rif.UCI/ALB/RF331-6/FR datë10 Shkurt 2020 e INTERFORCE Italia rezulton e provuar se: *"shtetasi Fatjon Murati i dtl.14.01.1990 lindur ne Kukes, është ndaluar nga policia me daten 28.02.2015 per vepren penale te blerjes se mallrave te vjedhur, posedim illegal te armeve dhe narkotikeve dhe si vijim me daten 12.03.2015 u vendos ne burgun e Venecias. Me daten 04.08.2015 është vendosur nën masen e arrestit shtepiak. Ne ngarkim masa e arrestit ne burg eshte dhene me daten 05.11.2015 nga GIP I Gjykates se Trevizos per shkelje te ligjit mbi posedimin e armeve, narkotikeve dhe blerje mallrash te vjedhur. Me date 08.08.2019 Prokuroria e Republikes prane Gjykates se Venecias ka dhënë në datën 08.08.2019 masen e ekzekutimit të dënimeve konkuruese me urdhrin për burgim nr.344/2019 duke qenë i dënuar me 5 vjet e 7 muaj e 5 ditë burgim"*. Ndërsa, nga shkresa me nr.4222/1Prot date 18.12.2019 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se shtetasi Fatjon Murati me vendimin nr.3090 datë 12.10.2016 të po kësaj Gjykate është denuar per vepren penale *"Ndërtim i paligjshëm"*.

24. Gjithashtu rezulton se më datë 08.10.2022 është bërë ndalimi i këtij shtetasi si i dyshuar për kryerjen e veprës penale *"Mbajtja pa leje te armeve dhe municionit luftarak shperthyese dhe municionit"*, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 278/5 dhe 25 i K.Penal. Arrestimi i ketij shtetasi është bërë pasi nga hetimet e zhvilluara ne funksion të procedimit penal nr.5257 te vitit 2022 jane siguruar fakte dhe prova se shtetasi Fatjon Ramazan Murati në bashkëpunim me shtetasin Kristjan Arben Gjini janë poseduesit zoteruesit e disa armeve zjarri te llojeve dhe kalibrave te ndryshem si fisheke silenciatore qe jane gjetur dhe sekuestruar ne cilesine e proves materiale gjate kontrollit te ushtruar me date 12.07.2022 ne ambientet e marra me qira nga shtetasi Arben Gjini.

25. Gjykata vlerwson tw theksoi se nga aktet e hetimeve paraprake deri nw kwto momente tw hetimit nuk rezulton që personi nwn hetim të ketë gjeneruar të ardhura të ligjshme sa të justifikojnë vënien e pasurive tw zotwruara nga vetë ai dhe familjarët e tij. Ndaj çmohet se ka dyshim të arsyeshëm të bazuar në prova se pasuritë e krijuara nga shtetasi Fatjon Murati dhe familjar të tij mund tw jenw krijuar nga burime tw paligjshme, nuk u pwrgjigjen nivelit të të ardhurave si dhe nuk justifikohen me të ardhurat e realizuara edhe prej aktiviteteve tregtare tw regjistruara nga familjarwt e personit nwn hetim, si dhe ka rrezik që disponimi i lirë i tyre mund të rendojë pasojat e veprës penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal, duke u tjetërsuar ose transferuar tek të tretët.

26. Sa më sipër gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e prokurorisë duhet pranuar si e bazuar në ligj dhe në prova.

**Në zbatim të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale,**

**<u>V E N D O S I:</u>**

1. Pranimin e kërkesës.
2. **Sekuestrimin e pasurive të paluajtshme:**

- *Pasuria nr. 4/40/ND+1-2, ZK. 8330, sip ndërtimi 120 $m^2$;*
- *Pasuria nr. 9/73-N7, ZK 8310, rruga "Lord Bajron" njësi shërbimi (dyqan) sip 40 $m^{2}$.;*
- *Pasuria nr.215/189+3-N14, ZK 3866, rruga "Shaban Matraku", apartament sip 90.30$m^{2}$.;*
- *Pasuria nr.4/40/ND+1-1, Zk 8330, një ndërtesë 7+1-katëshe me sipërfaqe ndërtimi 317$m^2$.*

3. **Sekuestrimin e pasurive të luajtshme:**

- *Aktiviteti tregtar i regjistruar si person fizik me NIPT L71814001H, hapur më datë 14.06.2017, me fushë veprimtarie, tregti me pakicë të artikujve të imët ushqimor;*
- *Aktiviteti tregtar i regjistruar si person fizik me NIPT L81619013E, me veprimtari Bar – Kafe;*
- *Aktiviteti tregtar regjistruar si person fizik me NIPT K81702028O, me objekt veprimtarie, lavazh makinash, në emër të shtetasit Ylli Murati;*

4. Caktimin e një administratori nga Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe Konfiskuara.
5. Një kopje e këtij vendimi t'i komunikohet prokurores Sonila Muhametaj.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brënda 10 ditëve duke filluar ky afat nga nesërmja e marrjes dijeni nga cilido që ka interes.

**U shpall në Tiranë, sot më datë 14.10.2022 Ora 12:30.**

**GJYQTARE**

**Oltjona GOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË MASAT E SIGURIMIT